

KUR FËMIJA JUAJ MUNGON, JU LUTEM:

1. Telefononi shkollën për të raportuar mungesën.
2. Dërgoni një shënim tek mësuesi ku t'i shpjegoni arsyen e mungesës.
3. Nëse e çoni fëmijën tuaj tek mjeku për shkak të ndonjë sëmundjeje, merrni një vërtetim dhe tregojani atë shkollës. Vërtetimi i mjekut do të shpjegojë mungesën – **jo të justifikojë** mungesën.
4. Kontrolloni për të parë nëse ka ndonjë punë që djali/vajza juaj mund të bëjë në shtëpi për të kompensuar kohën që ka humbur.
5. Pyesni shkollën nëse ka ndonjë hap tjetër që duhet të bëni.

UDHËZIMET E PJESËMARRJES SË SHKOLLËS JANË BAZUAR NË LIGJIN E PËRGJITHSHËM TË MASSACHUSETTS

Më poshtë është një përmbledhje e ligjit dhe politikave të Shkollave Publike të Worcester:

- Zhvillimi i zakoneve të mira të pjesëmarrjes fillon në Parashkollor dhe Kopësht.
- Fëmijët mësojnë menjëherë se të shkuarit në shkollë në kohë, çdo ditë, është e rëndësishme.
- Ligji i shtetit KËRKON që nxënësit midis moshës 6 – 16 të frekuentojnë shkollën.
- Me shtatë mungesa, një ankesë gjyqësore mund të ngrihet kundër një prindi/kujdestari për mos dërgimin e një fëmije në shkollë.
- Me tetë mungesa në një semestër, një ankesë gjyqësore mund të ngrihet për fëmijën për mungesa pa arsye.
- Me katërbëdhjetë mungesa, një nxënës mund të humbasë kreditet në klasë dhe të rrezikoië përsëritien.

Shkollat Publike të Worcester janë një Institucion Arsimor/Punëdhënës i Mundësisë së Barabartë/Veprimit Pozitiv dhe nuk diskriminojnë pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, moshja, feja, origjina kombëtare, identiteti gjinor, gjendja martesore, orientimi seksual, pa-afësia ose mungesa e shtëpisë. Shkollat Publike të Worcester sigurojnë mundësi të barabartë për punësim dhe sferën e plotë të programeve të përgjithshme, të punësimit dhe profesionale të arsimit.

Për më shumë informacion në lidhje me Veprimin e Mundësisë së Barabartë/ Veprimin Pozitiv, kontaktoni Administratorin e burimeve njerëzore, 20 Irving Street, Worcester, MA 01609, 508-799-3020.

SHKOLLAT PUBLIKE TË WORCESTER K ~ 12



TË SHKOJMË NË SHKOLLË!



www.worcesterschools.org

Pjesëmarrja e Rregullt Bën të Gjithë Diferencën!

Ndihmoni Fëmijën Tuaj të Ketë Sukses në Shkollë Duke Krijuar Zakonin e Pjesëmarrjes së Mirë të Herët

E DINIT SE?

- Pjesëmarrja e rregullt në shkollë ndihmon fëmijën të ndihet më mirë rreth shkollës – dhe vetes së tyre.
- Hulumtimet tregojnë se sa më shpejt të mësojë fëmija se shkolla është puna e tij apo e saj dhe se ai apo ajo ka një punë të rëndësishme për të bërë, aq më të suksesshëm do të jenë fëmijët në edukimin e tyre.
- Pjesëmarrja e mirë do të ndihmojë fëmijët të jenë mirë në shkollë të mesme, kolegji dhe punë.
- Të vonohesh në shkollë mund të çojë në pjesëmarrje të ulët dhe mundësi të humbura të mësimit.
- Mësimi fillon në momentin kur fëmijët vendosen në rutinat e tyre të mëngjesit. Kur një fëmijë është vonë për në shkollë, edhe për pak minuta, mësimi është ndërprerë.
- Nxënësit mund të mbeten pas nëse mungojnë vetëm një ose dy ditë në pak javë.
- Të mos jesh vazhdimisht i pranishëm (të mungosh 10 përqind të shkollës) mund ta bëjë të vështirë mësimin për të lexuar.
- Dy mungesa në muaj = 20 mungesa në vit. Nëse një fëmijë ka 18 mungesa në vit, në kohën kur të mbarojë Klasën e 9-të, ata kanë humbur ***një vit të plotë shkollor!***

MËNYRAT PËR TË NDIHMUAR FËMIJËN PËR TË KRIJUAR NJË RUTINË PËR TË QENË I PRANISHËM DHE NË KOHË NË SHKOLLË:

- Vendosni një kohë të caktuar të gjumit dhe të rutinës së mëngjesit.
- Bëni gati rrobat dhe paketoni çantën një natë më përpara.
- Mëngjesi shërbehet në shkollë çdo ditë, nëse fëmijët hanë një mëngjes të mirë ata janë gati për të mësuar.
- Flisni me fëmijën rreth rëndësisë së shkollës.
- Pyesni fëmijën çdo ditë se çfarë kanë bërë në shkollë dhe bëjeni atë një bisedë pozitive të detajuar.
- Mos lejoni që fëmija juaj të qendrojë në shkollë përveçse kur është shumë sëmure.
- Nëse fëmija duket i shqetësuar për të shkuar në shkollë, flisni me mësuesit, këshilltarët e rregullimit të shkollës ose prindërit e tjerë për këshilla se si ta bëni atë të ndihet rehat dhe i entuziazmuar për të mësuarit.
- Krijoni plane rezervë për të shkuar në shkollë nëse ndodh diçka. Telefononi një anëtar të familjes, një fqinj ose një prind tjetër.
- Shmangni takimet mjekësore dhe udhëtimet e gjata kur shkolla është në sesion.